

RAYMOND KHOURY  
**TEMPULLI I FSHEHTË**  
ROMAN  

---

BOTIMET TOENA



RAYMOND KHOURY

# TEMPULLI I FSHEHTË

roman

*Përktheu nga origjinali anglisht: Entela Gjatolli*

BOTIMET TOENA

Autor: Raymond Khoury

Titulli në origjinal: The sanctuary

Botoi në anglisht: Dutton (*pjesë e* Penguin Random House), 2007

Botuar në shqip në marrëveshje me Rachel Mills Literary Ltd.

Botuese: Irena Toçi

Redaktor letrar: Eris Rusi

Përkujdesja grafike *dhe* kopertina: Gea Qëndro

ISBN 9789928960405

© Raymond Khoury 2007

© *në shqip* BOTIMET TOENA 2026

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", nr. 71, Tiranë 1023

ose K. Postare 1420

Tel.: +355 67 70 70 884

botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Kur një shkencëtar i shquar thotë se diçka është e mundur, me shumë gjasa ka të drejtë. Kur thotë se diçka është e pamundur, e ka shumë gabim.

– *Artur C. Klark*

Tempus edax, homo edacior.  
Koha gllabëron, njeriu akoma më shumë.

– *Proverb i lashtë romak*



# PROLOG



# I

*Napoli - Nëntor 1749*

Gërvishtja zëre se nuk dëgjohej, por, prapëseprapë, e zgjoi nga gjumi. Nuk ishte aq e fortë sa të të zgjonte nga një gjumë i thellë, megjithëse, ai kishte vite që nuk flinte mirë.

Dukej si zhurma e metalit kur fërkohej pas gurit.

Mund të mos ishte asgjë. Diçka e parëndësishme, zhurmat e shtëpisë. Ndoshta një nga shërbëtorët ishte zgjuar herët.

Ndoshta.

Nga ana tjetër, mund të ishte diçka jo aq e parrezikshme. Si për shembull, një shpatë. Një shpatë që po fërkohej pa dashje pas murit.

*Dikush është këtu.*

Ai u ngrit dhe po dëgjonte me kujdes. Për një moment, mbizotëroi vetëm heshtja. Pastaj, dëgjoji diçka tjetër.

Hapa.

Duke ngjitur shkallët e ftohta gëlqerore.

Si një zhurmë e lehtë në ndërgjegjen e tij, por ishin padyshim hapa. Dhe po afroheshin.

U ngrit menjëherë nga krevati dhe shkoi drejt dritareve të mëdha që të çonin në një ballkon të vogël përballë oxhakut. Hapi perden nga njëra anë, shtyu derën ngadalë dhe doli në ajrin e acartë të natës. Dimri po afrohej shpejt dhe atij i ngrinë këmbët e zbathura në dyshtemenë e gurtë, akull të ftohtë. U përkul mbi parmak dhe hodhi vështrimin poshtë. Oborri i pallatit ishte i zhytur në errësi. Ai po shikonte me vëmendje, duke kërkuar për një pasqyrim apo një lëvizje të beftë, por

nuk pa asnjë shenjë jete poshtë. Nuk dukej asnjë kalë, asnjë karrocë dhe asnjë shërbëtor.

Matanë rrugës, siluetat e shtëpive të tjera mezi dalloheshin, të ndriçuara nga vezullimi i parë i agimit që fekste pas Vezuivit. E kishte parë shumë herë lindjen e diellit që prapa malit bashkë me vazhdën kërcënuese të tymit gri. Ishte një pamje madhështore, frymëzuese; një pamje që shumë herë i jepte ngushëllim kur asgjë tjetër nuk ia arrinte.

Kjo natë ishte ndryshe. E ndjente se diçka e keqe po vinte.

U fut menjëherë brenda dhe veshi një palë pantallona e një këmishë, pa i mbërthyer fare kopsat. Diçka më urgjente e priste. U afrua te komoja dhe hapi sirtarin e parë. Sa preku me dorë kamën, u hap dera e dhomës dhe tre burra u vërsulën brenda. Të tre me shpata në dorë. Nga drita e zbehtë e prushit në vatër, vuri re edhe një pistoletë në dorën e burrit në mes.

Drita ishte aq e fortë sa mjaftonte për të dalluar se kush ishte.

Menjëherë, e kuptoi për çfarë bëhej fjalë.

- Mos bëj ndonjë marrëzi, Montferat, - tha me zë të çjerrë kryetari i grupit.

Burri që mbante emrin Markezi i Montferatit ngriti duart lart me qetësi dhe u largua ngadalë nga komoja. Sulmuesit e rrethuan duke ia drejtuar shpatat në fytyrë, në shenjë kërcënimi.

- Ç' doni këtu? - i pyeti me kujdes.

Rajmondo di Sangro futi shpatën në këllëf dhe vendosi revolverin mbi tavolinë. Kapi një karrige dhe e shtyu me këmbë drejt markezit. Një e çarë në dysHEME bëri që karrigia të përmbysesj anash me zhurmë.

- Ulu, - hungëriu ai. - Besoj se kjo do të zgjasë ca.

Me shikimin e ngulitur te Di Sangroja, Montferati drejtoi karrigen dhe u ul me ngurrim.

- Çfarë do?

Di Sangroja u përkul mbi prush dhe ndezi një qiri të hollë, me të cilin ndezi fenerin me vaj. E vendosi mbi tavolinë dhe mori pistoletën, pastaj u bëri me shenjë njerëzve të tij të dilnin

jashtë. Të dy pohuan me kokë dhe dolën jashtë duke e mbyllur derën. Di Sangroja tërhoqi një karrige tjetër dhe u ul kaluar, ballë për ballë me prenë e tij.

- Ti e di shumë mirë se çfarë dua, Montferat, - iu përgjigj duke i drejtuar revolen me dy tyta gjithë kërcënim teksa e studionte dhe më pas shtoi me ton therës, - dhe mund të fillosh duke më thënë emrin tënd të vërtetë.

- Emrin tim të vërtetë?

- T'i lëmë lojërat, *markez*. - Fjala e fundit i doli në një mënyrë aq tallëse sa që mund t'ia lexoje përbuzjen në sy. -I kontrollova dokumentet e tua. Janë të falsifikuara. Në fakt, në ato pak copëza të vagullta që ke thënë për të shkuarën tënde, nga çasti që ke ardhur këtu, nuk ka asgjë të vërtetë.

Montferati e dinte se akuzuesi i tij i kishte të gjitha mjetet e nevojshme për ta bërë një hetim të tillë. Rajmondo di Sangro kishte trashëguar titullin "*Principe di San Severo*" - princi i San Severos - në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare, pas vdekjes së dy vëllezërve të tij. Mbreti i ri spanjoll i Napolit dhe Sicilisë, Karli III i Burbonit, ishte një ndër miqtë dhe admiruesit e tij.

"*Si munda të gaboj me këtë njeri?*", mendoi i kapluar nga tmerri. "*Si mund të kem gabuar kaq shumë me këtë vend?*"

Pas shumë vitesh torturash dhe dyshimesh te vetja, më në fund e kishte braktisur kërkimin e tij në Orient dhe s'kishte bërë as vitin që ishte kthyer në Evropë, duke mbërritur në Napoli nga Kostandinopoja dhe Venecia. Nuk kishte për qëllim të qëndronte në atë qytet. Kishte në plan të vazhdonte drejt Mesinës dhe prej andej, të shkonte me anije në Spanjë dhe ndoshta të kthehej në shtëpinë e tij në Portugali.

Ndaloi për një çast dhe mendoi.

"*Shtëpia.*"

Një fjalë domethënëse për të tjerët, por jo për të. Një fjalë boshe, e pastruar nga çdo rezonancë, ngaqë kish kaluar kaq shumë kohë.

Napoli ia kishte lënë pezull mendimin për t'u dorëzuar. Nën sundimin e vasalëve spanjollë, ishte bërë qyteti i dytë i Evropës, pas Parisit. Gjithashtu, ishte pjesë e Evropës së re që po zbulonte, një tjetër Evropë nga ajo që kishte lënë pas. Ishte vendi ku idetë e Iluminizmit po i udhëhiqnin njerëzit drejt një të ardhmeje të re, ide që ishin përqaftuar e ushqyer në Napoli nga Karli III, i cili ishte përkrahës i komunikimit, edukimit dhe debatit kulturor. Mbreti kishte themeluar Bibliotekën Kombëtare, si edhe Muzeun Arkeologjik për të ekspozuar reliktet e zbuluara në qytetet e groposura të Herkulanit dhe Pompeit që ishin zbuluar së fundmi. Diçka tjetër që e joshte edhe më shumë, ishte fakti se mbreti ishte armik i Inkuizionit, që shumë vite më parë, ia kishte bërë jetën të padurueshme Montferatit. Mosbesues kundrejt influencës së Jezuitëve, mbreti kishte vepruar me kujdes për t'i shtypur ata, gjë që arriti ta bëjë pa ngjallur zemërimin e Papës.

Kështu, ai mori emrin që kishte përdorur në Venecie shumë vite më parë, Markezi i Montferatit. E pati të lehtë të humbte në qytetin plot gjallëri dhe vizitorët e tij. Shumë vende të ndryshme kishin themeluar akademi në Napoli për të strehuar vizitorët e shumtë që shkonin për të studiuar në qytetet e sapo zbuluara romake. Shumë shpejt, filloi të takohej me eruditë, si vendas po ashtu edhe vizitorë nga e gjithë Evropa, njerëz kureshtarë që ndanin të njëjtat ide.

Njerëz si Rajmondo di Sangro.

Mendje vërtet kureshtarë.

- Gjithë këto gënjeshtër, - vazhdoi di Sangroja, duke matur revolen e duke e parë në sy me njëfarë lakmie të shfrenuar. - Dhe prapë, intriguese dhe disi e çuditshme, duke qenë se një zonjë e moshuar dhe mjaft e këndshme, kontesha e Cergit, pretendon se të ka njohur me këtë emër në Venecia... Para sa vitesh ishte? Tridhjetë? Apo më shumë?

Ky emër e shpoi markezin e rremë si tehu i një shpate. *Ai e di. Jo, nuk mund ta dijë. Por, dyshon.*

- Sigurisht, mendja e asaj gruaje plakë nuk është më siç ka qenë. Në fund të fundit, koha nuk ka mëshirë për asnjë, apo jo? - vazhdoi di Sangroja. - Po për ty, ishte aq këmbëngulëse, aq e qartë dhe aq e bindur që nuk e kishte gabim... vështirë t'i merrje fjalët e saj si përçartjet e një plake të mbaruar. Më vonë, marr vesh se e flet arabishten sikur të ishte gjuha e mëmës. Mësova se e njeh Kostandinopojën si pëllëmbën e dorës dhe se ke udhëtuar anembanë Lindjes duke u shtirur në mënyrë të përsosur si një sheik arab... ose të paktën kështu më kanë thënë. Janë shumë mistere për një njeri të vetëm, markez. Kjo hedh poshtë çdo besueshmëri, apo logjikë.

Montferati u vrenjt përbrenda, duke mallkuar veten që e konsideroi këtë njeri të ngjashëm me veten e tij, si një aleat të mundshëm. I vinte inat me veten që lejoi ta testonin dhe hetonin, ndonëse në fshehtësi.

Po, e kishte gjykuar shumë gabim atë njeri. Po mendoi se ndoshta kështu kishte qenë e shkruar. Ndoshta kishte ardhur koha ta hiqte atë barrë nga vetja. Ndoshta kishte ardhur koha që gjithë bota ta mësonte sekretin e tij. Ndoshta ai njeri do ta gjente një mënyrë për ta përballuar me fisnikëri dhe bujari.

Di Sangroja nuk po ia ndante sytë dhe dukej sikur po i studionte çdo dridhje në fytyrë.

- Jepi, trego! U ngrita nga shtrati në këtë orë të pazakontë vetëm për të dëgjuar historinë tënde, *markez*, - tha ai me arrogancë. - Dhe, të them të drejtën, nuk më intereson shumë se kush je në të vërtetë apo nga je. Dua vetëm të di sekretin tënd.

Montferati e ktheu menjëherë shikimin nga hetuesi i tij.

- Më mirë mos ta dini, princ. Më besoni. Nuk është dhuratë, për askënd. Është mallkim, e thënë thjesht. Një mallkim nga i cili nuk ka shpëtim.

Di Sangros nuk i bëri përshtypje kjo.

- Pse nuk më lë ta gjykoj vetë nëse është mallkim apo jo?

Montferati u përkul përpara.

- Ju keni familje, - tha ai, me një zë të mekur e të largët. -

Keni grua e fëmijë. Mbretin e keni mik. Çfarë mund të kërkojë më shumë një njeri?

Përgjigja e tij ishte shqetësuese.

- Më shumë. Dua të gjitha këto, dhe më shumë.

Montferati tundi kokën.

- Lërimi gjërat kështu siç janë.

Di Sangroja u afrua më shumë drejt robit të tij. Sytë i shkëlqenin me zjarr, ethshëm.

- Dëgjo këtu, *markez*. Ky qytet, ky mbret-çilimi i parëndësishëm... nuk janë asgjë. Nëse dyshimet që kam për çka di ti janë të vërteta, mund të bëhemi perandorë. Nuk e kupton? Njerëzit do të shisnin edhe shpirtin për këtë.

Markezi i rremë nuk dyshoi për asnjë çast.

- Pikërisht kësaj i druhem.

Di Sangroja po turfullonte nga inati teksa përpiquej t'i blinte mendjen tjetrit. Diçka në kraharorin e Montferatit bëri që t'i ulte sytë menjëherë poshtë, me një kureshtje të paparë. U përkul në një mënyrë kërcënuese dhe zgjati dorën sipër tavolinës, për të tërhequr një medaljon nën këmishën e zberthyer të markezit të rremë. Montferati ngriti dorën menjëherë dhe e mbërtheu kyçin e Di Sangros, por princi ngriti revolen me shpejtësi dhe i hoqi siguresën. Montferati e lëshoi ngadalë. Princi e mbajti medaljonin në dorë edhe për pak çaste, pastaj e tërhoqi fort duke ia këputur zinxhirin e duke ia shkullur nga qafa Montferatit. Ai e afroi medaljonin nga vetja duke e ekzaminuar me kujdes.

Ishte një rreth i thjeshtë prej bronzi, si një monedhë e madhe, me diametër pak më shumë se dy gisht. Kishte vetëm një simbol në të; një gjarpër që e mbështillte medaljonin si një unazë, me kokën në majë të rrethit të krijuar nga vetë trupi i tij.

Po gllabëronte bishtin e vet.

Princi i hodhi një vështrim pyetës Montferatit. Po nuk mund të kuptonte asgjë nga shikimi i ftohtë i markezit të rremë.

- U lodha duke pritur, *markez*, - psherëtiu Di Sangroja me një ton kërcënues. - U lodha duke u përpjekur t'i gjej kuptimin këtij, - u çor duke e shtrënguar medaljonin në dorë dhe duke ia tundur me inat Montferatit. - U lodha nga përgjigjet e tua misterioze, nga përpjekjet për të deshifruar referencat e tua pakuptueshme. U lodha duke dëgjuar se u bën pyetje disa shkollarëve e vizitorëve dhe duke zbuluar vetë atë që tani besoj se është e vërtetë për ty. Dua ta di. *Kërkoj* ta di. Pra, është në dorën tënde. Mund të ma thuash tani, këtu. Ose mund ta marrësh me vete në varr.

Di Sangroja ia afroi revolverin edhe më shumë. Tani, tytat e revoles ishin vetëm pak centimetra larg fytyrës së robit të tij. E la për një çast të ndihej i kërcënuar.

- Por, nëse ky do të ishte vendimi yt, - shtoi ai, - të vdesësh sonte duke marrë me vete gjithçka di, do të të kërkoja të reflektoje mbi një gjë: ku e gjen të drejtën të na e mohosh neve këtë informacion, të shpërfillësh botën duke e lënë në padije? Çfarë ke bërë ti që të meritosh të drejtën për të vendosur për të gjithë ne?

Kjo ishte një pyetje që Montferati ia kishte bërë vetes shumë herë, pyetje që e kishte përndjekur gjithë jetën.

Në një të shkuar të largët, një burrë tjetër, një plak i moshuar të cilin e kishte parë të vdiste, një mik për vdekjen e të cilit u bë edhe shkaktar - të paktën në mendjen e tij - pikërisht ai njeri e kishte bërë atë zgjedhje për të. Në frymën e fundit, miku i tij e tronditi, duke i thënë se pavarësisht veprimeve mjerane dhe të urryeshme të Montferatit, ai mund ta dallonte hezitimin dhe dyshimin në sytë e tij. Në njëfarë mënyre, plaku ishte i sigurt se guximi, fisnikëria dhe ndershmëria e këtij djaloshi të ri ishin ende aty, të groposura thellë në markezin e rremë, të

mbytura nga ideja e gabuar e detyrës. Në orën e tij më të errët, ky mik arriti të gjente një premtim dhe një qëllim në jetën e atij djaloshi të ri, diçka nga e cila markezi i rremë kishte hequr dorë me kohë. Bashkë me të, erdhi edhe një bindje, një zbulim dhe një mision që do të konsumonte jetën e Montferatit.

Dikush tjetër e kishte marrë vendimin për të. Të drejtën për të vendosur, Montferati e kishte trashëguar nga një njeri, të cilin e konsideronte shumë herë më të denjë se veten.

Po edhe vetë u habit.

Ai bëri ç'mundi, u përpoq me të gjitha forcat që të zbulonte çfarë përmbanin faqet që mungonin nga kodeksi.

Kishte arritur t'u shpëtonte akuzuesve të tij në Portugali. E kërkoi kodeksin në Spanjë dhe në Romë. Udhëtoi në Kostandinopojë dhe më tej, në Lindje, por nuk mundi të zbulonte asgjë.

Kishte dështuar.

Dhe tani ishte në një udhëkryq.

Mendoi se kthimi në tokën e lindjes do ta ndihmonte të vendoste se cili do të ishte hapi i radhës. Ndërprerja e Di Sangros e la pezull gjithë këtë. Në mjegullën që i mbështolli mendjen, një mendim i fekste shumë qartë: ta shpërfillte personin që kishte përballë duke e lënë në padijeni, ishte një zgjedhje që do ta bënte me shumë dëshirë.

Sa për pjesën tjetër të botës... kjo ishte çështje tjetër.

- Atëherë? - ulëriti di Sangroja, me dorën që po i lëkundej nga pesha e revoles.

Burri që e quante veten Montferat, brofi nga karrigia dhe iu vërsul armikut të tij, u zgjat përpara dhe shtyu revolen pikërisht në çastin kur di Sangroja tërhoqi këmbëzën. Kapsolla plasi me një gjëmim shurdhues, teksa dy burrat po përlesheshin për të rrëmbyer armën, ndërkohë plumbi doli nga tyta e sipërme, gati sa nuk i fshiku veshin Montferatit dhe ngeci në panelin e murit pas tij. Dy burrat u përplasën me tavolinën buzë oxhakut, dhe

po vazhdonin të përlesheshin për armën, kur dera e dhomës u hap me forcë. Njerëzit e di Sangros u sulën menjëherë brenda, me shpatat në dorë. Montferati e kapi shpërqendrimin e çastit në sytë e kundërshtarit dhe shfrytëzoi rastin, duke i dhënë “*principe*”- s një bërryl të fortë mu në fyt. Princi u spraps për shkak të goditjes, duke e liruar shtrengimin e pistoletës, aq sa Montferati arriti t’ia rrëmbente nga dora. Ky i fundit, e shtyu tutje princin dhe drejtoi revolen, lëvizi shulin dhe mori shenjë teksa iu shmang ndihmësit të parë që po e sulmonte dhe qëllloi. Plumbi e kapi burrin në kraharor, duke e bërë të rrotullohej anash dhe të binte në tokë te këmbët e Montferatit.

Montferati e lëshoi pistoletën bosh me forcë drejt sulmuesit të dytë dhe sakaq mori shpatën e të vrrarit. Princi e kishte marrë disi veten dhe sado që nuk mund të qëndronte në këmbë, nxori shpatën.

- Mos e vrit, - tha duke bërë një hap përpara për t’u bashkuar me ndihmësin e tij. -Më duhet i gjallë... tani për tani.

Montferati e kapi shpatën me të dyja duart duke e ngritur lart si për t’u mbrojtur, dhe po e tundte sa majtas e djathtas për të mbajtur larg sulmuesit. Dy burrat që kishte përballë dukeshin të paduruar, dhe, nga përvoja e tij e dinte se qëndrimi ishte një armë po aq efikase sa edhe shpata. Ai do të priste të bënin ndonjë gabim. Ndhimësi donte të tregonte zotësinë e tij dhe u hodh përpara i nxituar. Montferati ia bllokoi goditjen me shpatë dhe me këmbën e zbathur, e shkelmoi me sa fuqi kishte në kofshë. Burri klithi nga dhimbja dhe me bishtin e syrit, Montferati pa se princi ishte tërhequr me zgjuarsi. Ai vendosi të hiqte qafe sulmuesin e parë dhe vërtiti shpatën, duke e përplasur me tehun e kundërshtarit me aq shumë forcë, sa ia hoqi nga dora. Princi ulëriti nga inati dhe u sul përpara, duke e ndërprerë Montferatin i cili tani duhet ta drejtonte shpatën tjetërkund. Montferati arriti ta sprapste sulmuesin e parë me një shkelm, para se të kthehej nga di Sangroja.

Ndihmësi ra mbrapsht, u përplas me forcë me tavolinën dhe që aty, përfundoi mbi oxhakun e madh. Shkëndijat dhe prushi fluturuan nga vatra teksa po ulërinte me të madhe nga dhimbja në dorën e përcëlluar, me të cilën u përpoq të mbahej kur ra. Montferati pa se mënga e tjetrit kishte marrë zjarr kur feneri, i cili kishte rënë nga tavolina, i vuri flakën tapetit.

Markezi i rremë u hodh t'i shmangej goditjes së Di Sangros para se flakët nga tapeti të fshiknin perden e trashë kadife dhe ta gllabëronin. Nxehtësia dhe tymi në dhomë ishin të tmerrshëm teksa princi luftonte pamëshirë dhe e zuri në befasi Montferatin me një goditje të fortë që ia hoqi shpatën nga dora. Montferati bëri një hap prapa, në përpjekje për të shmangur tehun e shpatës së Di Sangros të cilën e kishte shumë pranë fytit. Përmes tymit të dendur në dhomë, Montferati pa se banditi me dorën e djegur kishte arritur të shuante flakët nga mënga dhe tani po ngrihej për t'iu bashkuar përlëshjes. Burri lëvizti anash, duke u pozicionuar para derës së dhomës për të bllokuar çdo tentativë arratisjeje të Montferatit.

Armiku kishte epërsi në numër dhe armë, dhe Montferati e dinte këtë.

Duke hedhur sytë sa majtas e djathtas, Montferati pa një mundësi shpëtimi dhe vendosi të rrezikonte. Ai ngriti duart lart dhe iu afrua perdes që po digjej, me shikimin e ngulitur nga di Sangroja.

- Duhet të shuajmë zjarrin para se të përhapet në katet e tjera, - bërtiti Montferati duke iu afruar perdes me kujdes.

- Në djall katet e tjera, - ia ktheu Di Sangroja, - për sa kohë që flakët nuk përfshijnë atë për të cilën folëm.

Montferati i ishte afruar më shumë perdes që po digjej. Palltoja gjysmë e djegur e ndihmësit ishte hedhur në tokë, duke u djegur ngadalë në vetvete. Montferati bëri lëvizjen e tij. Mori pallton për të mbrojtur duart teksa u zgjat mes flakëve, shkuli perden nga shinat dhe ia hodhi di Sangros

dhe ndihmësit të tij. Flakët e perdes e mbuluan ndihmësin e princit, i cili ulëriti i tmerruar teksa përpiqej ta hiqte nga vetja. Perdja e mbështolli në përçafimin e flaktë derisa më në fund arriti ta hidhte në tokë, ku krijoi një barrierë zjarri mes tyre dhe presë. Montferati nuk priti. Hapi derën e ballkonit dhe u zhduk në terrin e natës.

Pas nxehtësisë në dhomë, fladi i ftohtë që frynte nga gjiri e goditi në fytyrë si një shuplakë. Teksa hodhi një shikim të shpejtë brenda dhomës, ai pa Di Sangron dhe ndihmësin e tij gjysmë të djegur duke shkelur flakët dhe duke ecur përreth zjarrit për ta ndjekur nga pas. Di Sangroja ngriti kokën dhe sytë e tij u ndeshën me Montferatin. Montferati tundi kokën dhe shumë i nervozuar, u ngjit mbi parmak dhe u hodh poshtë.

Ai ra me zhurmë në ballkonin e dhomës një kat më poshtë. Nga hedhja e fortë, ndjeu një dhimbje therëse në nofull, te dhëmbët e deri në çaçkë të kokës. E hoqi mendjen nga dhimbja dhe brofi në këmbë, u ngjit në parmakun me hekur të farkëtuar dhe u hodh në çatinë e dalë dy kate më poshtë, ndërkohë që Di Sangroja doli në ballkon.

Kapeni! - ulëriti Di Sangroja në errësirë teksa qëndronte aty, i ndriçuar nga flakët si një djall nga ferri. Montferati hodhi sytë nga hyrja e pallatit dhe pa dy burra duke vrapuar në errësirë, të ndriçuar nga drita e fenerit që mbante në dorë njëri prej tyre. Montferati kaloi matanë dhe u hodh në çatinë e një ndërtese ngjitur, duke bërë që tjegullat të binin poshtë me zhurmë. Hodhi sytë nga çatitë dhe oxhaqet përpara, duke planifikuar rrugën e arratisjes. Ai e dinte se mund t'i shpëtonte ndjekësve dhe të zhdukej në errësirën e qytetit të dendur.

Më shumë e shqetësonte ajo që e dinte se do të ndodhte më pas.

Pasi të merrte thesarin e tij të çmuar që e mbante të fshehur në një vend të sigurt, larg pallatit - një masë paraprake që e merrte gjithmonë - do t'i duhej të largohej që aty.

Do t'i duhej të gjente një emër të ri dhe një shtëpi të re.

Ta rishpikte veten. Përsëri.

E kishte bërë më parë.

Do ta bënte sërish.

Ai e dëgjoi Di Sangron të ulërinte “Montferat” në errësirën e natës si një njeri i pushtuar nga djalli. E dinte se ky nuk ishte fundi. Një njeri si Di Sangroja nuk do të dorëzohej aq lehtë. Ishte infektuar nga një lakmi e sëmurë që, pasi të shtinte në dorë, nuk të lëshonte më.

Kjo ide e tmerroi deri në palcë teksa u zhduk në errësirë.